



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 173, datë 31.08.2018

PËR
MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË STATUTIN E SHOQËRISË SË BROKERIMIT
“SUNTRUST BROKER” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 209 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të neneve 8 e 12 të Rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, e ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të pikës 3 të nenit 9 “Kapitali i regjistruar i shoqërisë”, të statutit të shoqërisë së brokerimit “SunTrust Broker” sh.a., si rezultat i ndryshimit të strukturës aksionere, me përmbajtjen që vijon:

“9.3. Kapitali i shoqërisë zotërohet nga 4 (katër) aksionarë, si më poshtë vijon:

- Z. Robert Alia, i biri i Gjovalinit dhe Bardhes, lindur në 10.03.1990, në Fushë Arrëz, Pukë dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës ID nr.033505899, nr. Personal I10209134E, zotëron 105 (njëqind e pesë) aksione, me vlerë nominale prej ALL 1.050.000 (një milionë e pesëdhjetë mijë) që përfaqësojnë 30% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë,
- Z. Rigels Kasneci i, i biri Janit dhe Shpresës, lindur ne 09.02.1981, në Tiranë dhe banues në Tiranë në Rr. “Sulejman Delvina”, Ndërtesa 17, H.19, AP.5, Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i ID nr.033505899, nr. Personal I10209134E, zotëron 105 (njëqind e pesë) aksione, me vlerë nominale ALL 1.050.000 (një milionë e pesëdhjetë mijë) që përfaqësojnë 30% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë,
- Zj. Dhorothëa Male, e bija e Gëzimit dhe e Violetës, lindur në 20.06.1981 në Tiranë dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës (ID)

nr.029580808, nr. Personal J15620162R, zotëron 35 (tridhjetë e pesë) aksione, me vlerë nominale prej ALL 350.000 (treqind e pesëdhjetëmijë) që përfaqësojnë 10% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

- Zj. Gerjola Çaushi, e bija e Hysenit dhe Adelinës, lindur në 20.09.1992 në Tiranë dhe banuese në Tiranë, madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës (ID) nr.028763553, nr. Personal J25920115R, zotëron 105 (njëqind e pesë) aksione, me vlerë nominale ALL 1.050.000 (një milionë e pesëdhjetë mijë) që përfaqësojnë 30% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.”

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI